

Ligj për Kornizën kombëtare të kualifikimeve

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen Korniza kombëtare e kualifikimeve, nivelet dhe nënnivelet e kualifikimeve, tipet e kualifikimeve, vëllimi i kualifikimeve, trupat kompetente për propozim, miratim dhe klasifikim të kualifikimeve, institucionet kompetente që do të veprojnë në pajtim me këtë ligj, si dhe lidhja e Kornizës kombëtare të kualifikimeve me Kornizën evropiane të kualifikimeve dhe Kornizën kualifikuese të Hapësirës evropiane të arsimit të lartë.

Definicione

Neni 2

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. "Korniza kombëtare e kualifikimeve (KNK)" është instrument për vendosjen e sistemi të kualifikimeve të marra në vend të caktuar, me të cilin jepet baza për marrjen e kualifikimeve, kalim dhe kualitet të kualifikimeve;
2. "Korniza maqedonase e kualifikimeve (KMK)" është standard i obliguar nacional me të cilin rregullohet marrja dhe shfrytëzimi i kualifikimeve në Republikën e Maqedonisë dhe instrument për vendosjen e sistemi të kualifikimeve të marra në Republikën e Maqedonisë me të cilët jepen bazat për kontroll, qasje, kalim, marrje dhe kualitet të kualifikimeve;
3. "Korniza evropiane e kualifikimeve (KEK)" (European Qualifications Framework, EQF)“ paraqet kornizë të përbashkët referente që i lidh sistemet e kualifikimeve në vendet e ndryshme dhe paraqet instrument për njohje dhe kuptim të kualifikimeve;
4. "Korniza e kualifikimeve në Hapësirën evropiane të arsimit të lartë (Qualifications Framework for the European Higher Education Area, QF-EHEA)“ është instrument për vendosjen e niveleve të kualifikimeve në sistemin e arsimit të lartë për njohje dhe kuptim të kualifikimeve ndërmjet kornizave kombëtare në hapësirën evropiane të arsimit të lartë;
5. "Aftësi" është aftësia për zbatimin e diturisë, kryerjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve. Aftësitë janë përshkruar si kognitive (përfshirje të përdorimit të mendimit logjik, kreativ dhe intuitiv) dhe praktike (punë manuale dhe përdorim i metodave, instrumenteve, veglave dhe materialeve);
6. "Dituri" është shuma e informatave të marra dhe sistematizuara, përkatësisht shuma e informatave teorike dhe praktike;

7. "Mësim i përjetshëm" është aktivitet i mësimi forma, joformal dhe informal gjatë tërë jetës me qëllim përmirësimin e diturisë, aftësive dhe kompetencave për nevoja personale profesionale dhe shoqërore;
8. "Institucion" është enti ose institucioni tjetër që është i verifikuar/akredituar të arsimojë, trajnojë dhe vlerësojë pjesëmarrës që marrin kualifikime. Institucionet ofrojnë programe formale dhe joformale që çojnë te kualifikimet dhe japin dokumente publike për të njëjtat;
9. "Kualifikim" është rezultati formal nga procesi i vlerësimit dhe vërtetimit që është marrë kur institucioni përgjegjës vërteton se individi i ka arritur rezultatet nga mësimi në pajtim me standardet e përcaktuara;
10. "Kompetenca" janë shuma e diturive dhe aftësive të marra, përkatësisht aftësi e dëshmuar për shfrytëzimin e diturisë dhe aftësive në situata të mësimi ose në punë;
11. "Kompetenca kryesore" janë shumë e kompetencave në nivel të caktuar, të nevojshme për plotësimin e nevojave personale, shoqërore dhe profesionale të individit në procesin e mësimi të përjetshëm. Ekzistojnë tetë kompetenca kryesore: komunikimi në gjuhën amtare, komunikimi në gjuhën e huaj, kompetenca matematikore teknike dhe shkencore, vetëdija qytetare, teknologjia informatike, sipërmarrësia, mësimi si të mësohet dhe shprehja kulturore;
12. "Kredi sistemi" është sistem për akumulim dhe transfer të kredive në bazë të transparencës së rezultateve nga mësimi dhe proceset e mësimi;
13. "Kredi" është masa kuantitative për shprehjen e vëllimit të mësimi në bazë të vëllimit të punës që u nevojitet pjesëmarrësve me qëllim që t'i arrijnë rezultatet e pritura nga procesi i mësimi në nivel të dhënë;
14. "Kredi transferi" është procesi nëpërmjet të cilit rezultateve nga mësimi të arritura në një sistem ose institucion mund t'u caktohet vlerë në sistem ose institucion tjetër;
15. "Modul" është njësi e pavarur e mësimi që paraqet tërësi të rrumbullakuar ose një pjese të programit arsimor;
16. "Nivele në kornizë" është seri e hapave të njëpasnjëshëm të mësimi, të shprehura në raport me një varg të rezultateve të përgjithshme, të strukturuar sipas shumës së përshkrimeve/deskriptorëve;
17. "Përshkrim i kualifikimeve" janë tregues matës për rezultatet nga mësimi që kanë të bëjnë me dituritë, aftësitë dhe kompetencat e marra;
18. "Vlerësim" është proces i vlerësimit të diturisë, aftësive dhe kompetencave sipas kritereve të definuara paraprakisht dhe rezultateve të mësimi, që përfshin teste me shkrim, gojore dhe praktikë, provime, projekte dhe portfolio;

19. "Rezultate nga mësimi" janë deklarata për atë çka di, çka kupton dhe çka mund të bëjë pjesëmarrësi, si rezultat i procesit formal, joformal ose informal të mësimit. Rezultatet nga mësimi definojnë në kuptim të diturive, aftësive dhe kompetencave (pavarësi dhe përgjegjësi);

20. "Program (arsimor/studimor)" është shuma e komponentëve arsimore, të bazuara në rezultatet nga mësimi, që pranohen për ndarjen e kualifikimit konkret;

21. "Mësim formal" është veprimtaria e siguruar nga institucioni arsimor ose institucioni për trajnim që zbatohet sipas programeve të caktuara të lejuara, me qëllim që të avancohen dituria, aftësitë dhe kompetencat për çfarë jepet dokument publik;

22. "Mësim joformal" janë aktivitete të organizuara të mësimit me qëllim avancim të diturisë, aftësive dhe kompetencave për nevoja personale, shoqërore dhe profesionale dhe më së shpeshti nuk çon te dhënia e dokumentit publik dhe

23. "Mësim informal" është mësimi që del nga aktivitetet e përditshme jetësore të lidhura me punën, familjen ose me kohën e lirë. Ky nuk është i strukturuar në raport me qëllimet e mësimit, kohën e mësimit ose përkrahjen në mësim.

Parime

Neni 3

Korniza kombëtare e kualifikimeve (në tekstin e mëtejshëm: KNK) bazohet në këto parime:

- rezultatet nga mësimi shprehen nëpërmjet diturisë, aftësive dhe kompetencave,
- klasifikimi i kualifikimeve në nivele dhe nënivele,
- bartje e kredive,
- krahasimi me Kornizën evropiane të kualifikimeve (në tekstin e mëtejshëm: KEK),
- sigurimi i kualitetit në procesin e marrjes dhe zhvillimit të kualifikimeve,
- sigurimi i kushteve për kapshmëri të barabartë të arsimit gjatë të gjithë jetës për fitimin dhe njohjen e kualifikimeve,
- përforcimi i konkurrencës së ekonomisë maqedonase që bazohet në potenciale njerëzore,
- vendosje e sistemi të koordinuar të sigurimit të kualitetit të kualifikimeve ekzistuese dhe të reja dhe
- ndërtimi i sistemit të vlerësimit të mësimit joformal dhe informal.

Qëllime

Neni 4

KNK ka për qëllim:

- në mënyrë të qartë t'i definojë rezultatet nga mësimi,
- të vendosë sistem të vlerësimit të kualifikimeve të ndryshme në korniza të sistemit të tërësishëm të kualifikimeve,
- nxitjen dhe zhvillimin e mësimit gjatë tërë jetës (mësim i përvetshëm),
- t'i tregojë lidhjet e qarta ndërmjet pjesëve të ndryshme të sistemit arsimor,
- të sugjerojë në kalimin dhe avancimin (horizontal dhe vertikal) nëpërmjet dhe në korniza të të

gjitha llojeve të arsimit dhe trajnimit (formal, joformal dhe informal),

- të mundësojë krahasim ndërkombëtar të kualifikimeve,
- ta promovojë rëndësinë e kompetencave kryesore dhe profesionale,
- të sigurojë mobilitet të pjesëmarrësve në procesin e arsimit dhe trajnimit, si dhe përfshirje në tregun e punës në nivel nacional dhe ndërkombëtar,
- të krijohet sistem unik për menaxhim me kualitet,
- ta barazojë kualitetin e ofruesve të shërbimeve,
- të sigurojë bashkëpunim të të gjitha palëve të interesuara,
- të sigurojë harmonizim me nevojat ekonomike, sociale dhe kulturore të Republikës dhe
- të jetë pjesë e sistemit në korrelacion me zhvillimi e aktiviteteve të Kornizës evropiane të klasifikimeve.

II. KORNIZA MAQEDONASE E KUALIFIKIMEVE

Korniza maqedonase e kualifikimeve

Neni 5

Korniza maqedonase e kualifikimeve është përshkrim i njohur i obligueshëm unik ndërkombëtar me të cilat përshkruhen të gjitha kualifikimet e lidhura në mënyrë të ndërsjellë dhe rezultatet nga mësimi dhe përcaktohen marrëdhëniet ndërmjet kualifikimeve.

Standard i kualifikimit

Neni 6

Standardin e kualifikimit nga neni 5 të këtij ligji e përbëjnë:

- emri i kualifikimit,
- tipi i kualifikimit;
- niveli, përkatësisht nëniveli i kualifikimit,
- kodi i kualifikimit,
- vlera kreditore e kualifikimit,
- përshkrimi i kualifikimit dhe
- përmbajtja e kualifikimit (kushtet për regjistrim, numri i lëndëve përkatësisht moduleve të obligueshme dhe zgjedhore, mënyra e kontrollit dhe kriteret për kontroll të rezultateve nga mësimi).

Struktura e Kornizës maqedonase të kualifikimeve

Neni 7

(1) Korniza maqedonase e kualifikimeve i përfshin:

- nivelet, përkatësisht nënivelet e kualifikimeve,
- përshkrimin e niveleve dhe rezultateve nga mësimi për çdo nivel të kualifikimit,
- llojet e kualifikimeve dhe dokumenteve me të cilat dëshmohet kualifikimi i marrë dhe
- vëllimin e kualifikimit.

(2) Përshkrimet e rezultateve nga mësimi nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni janë:

Niveli	Dituri dhe kuptim	Aftësi	Kompetenca
	<p>Tregon kuptim sistematik në fushën e hulumtimit dhe njohje të përkryer të metodave dhe aftësive për hulumtim në korniza të asaj fushë në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare.</p> <p>Posedon dituri të fituar me hulumtim ose punë personale me të cilën jep kontribut të rëndësishëm në fushën profesionale dhe shkencore, por edhe në fusha të ngjashme me të.</p>	<p>Tregon aftësi të interpretojë, dizajnojë, zbatojë dhe adaptojë lëndë thelbësore të hulumtimit me integritet shkencor.</p> <p>E shfrytëzon diturinë e vet si bazë për ide dhe hulumtime origjinale të cilat i tejkalojnë kufijtë ekzistues të diturisë, duke zhvilluar dituri të reja, të vlerësuara në nivel të publikimeve kombëtare dhe publikimeve ndërkombëtare të recensuara;</p> <p>Aftësi për analizë kritike, vlerësim dhe sintezë të ideve të reja dhe të ndërlikuara, të domosdoshme për zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara në fushën e hulumtimit;</p> <p>Aftësim për inicim të pavarur dhe pjesëmarrje në rrjete dhe ngjarje kombëtare dhe ndërkombëtare hulumtuese me integritet shkencor.</p> <p>Aftësi për inicim të pavarur të projekteve hulumtuese dhe zhvillimore, nëpërmjet të cilave do të gjenerojë dituri dhe aftësi të reja për zhvillim në fushën e hulumtimit.</p> <p>Pritet të jetë i aftë të promovohet në korniza akademike dhe profesionale dhe në zhvillimin teknologjik, shoqëror ose kulturor të bazuar në dituri.</p> <p>Mund të komunikojë me kolegët e vet, bashkësinë më të gjerë akademike dhe me shoqërinë në</p>	<p>Ndërmerr përgjegjësi maksimale për rezultatet nga puna e vet personale, por edhe për punën e të tjerëve në grup.</p> <p>Ndërmerr përgjegjësi për udhëheqje me procese të ndërlikuara, me kujdes të njëkohshëm për zhvillimin profesional të individit dhe të grupit në tërësi.</p>

VIII

		tërësi në korniza të sferës së vet të ekspertizës.	
	Tregon dijëni dhe kuptim për sferën shkencore të hulumtimit (ose studimit) që mbindërtohet mbi ciklin e parë, duke zbatuar metodologji përkatëse për zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara, si në mënyrë sistemore ashtu edhe në mënyrë kreative, që siguron bazë ose mundësi për origjinalitet në zhvillimin dhe/ose zbatimin e ideve autonome në kontekst të hulumtimit.	Aftësi për zgjedhje kritike, të pavarur dhe kreative të problemeve me origjinalitet të caktuar në mjedise të reja ose të panjohura dhe në kontekst multidisiplinor, të lidhura me fushën e studimit.	Tregon përgjegjësi të rëndësishme për rezultatet personale dhe të përbashkëta, për mbajtjen dhe iniciimin të Aktiviteteve.
VII	Tregon nivel të lartë të kompetencës profesionale në një ose në më shumë fusha specifike Shkencore.	Aftësi për sintetizim dhe integrim të diturisë dhe për ballafaqim me çështje të ndërlikuara, në mënyre sistematike dhe kreative;	Aftësi për vlerësim solid bile edhe gjatë informatave të paplota dhe të kufizuara, por të cilat i përfshijnë përgjegjësitë personale, shoqërore dhe etike gjatë zbatimit të diturisë së fituar dhe vlerësimit;
	Posedon dituri për një ose më shumë sfera lëndore që në fushat e dhëna shkencore, bazohen në hulumtime shkencore më me renome në atë fushë shkencore, si dhe aftësi për lidhje të diturisë së zgjeruar dhe të thelluar në profesione ose sfera të ngjashme shkencore.	Aftësi për vlerësim dhe seleksionim të teorive shkencore, metodologjive, veglave dhe aftësive të përgjithshme nga sferat e lëndës, dhe vendosjen e analizave dhe zgjidhjeve të reja në bazë shkencore.	Aftësi për ndërmarrjen e përgjegjësisë për zhvillim dhe përsosje të mëtejme profesionale, si personale, po ashtu edhe për grupin me të cilën bashkëpunon.
		Aftësi për njohjen e nevojës personale për dituri të mëtejme dhe aftësi për ndikim të pavarur dhe të mëvetësishëm gjatë fitimit të diturive dhe aftësive të reja në kornizat shoqërore.	
		Aftësi për shkëmbim të konkluzioneve dhe propozimeve me argumentim dhe mbështetje racionale të të njëjtave, si me persona profesionale, ashtu edhe me persona joprofesionale, në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë.	
Vi	Tregon dituri dhe kuptim në fushën shkencore të studimit që mbindërtohet mbi trajnimin dhe arsimin paraprak, duke përfshirë edhe njohuri në dhomën të perspektivave teorike, praktike, konceptuale krahasuese dhe	Mund ta zbatojë dijeninë dhe kuptimin në mënyre që tregon qasje profesionale në punë ose profesion;	Ndërmerr përgjegjësi për rezultatet personale dhe përgjegjësi të ndarë për rezultate kolektive;
		Tregon aftësi për identifikimi, analizë dhe zgjedhje të	Aftësi për pjesëmarrje

kritike në fushën shkencore sipas metodologjisë përkatëse.

Kuptim të fushës së caktuar dhe njohje të çështjeve rrjedhëse lidhur me hulumtimet shkencore dhe burimet e reja të diturisë.

Tregon dituri dhe kuptim për teori dhe metodologji të ndryshme të domosdoshme për fushën më të gjerë të hulumtimit.

problemeve;

Aftësi për gjetjen dhe ngritjen të argumenteve në kornizat e profesionit ose fushën e studimit.

Aftësi të grumbullojë, analizojë, vlerësojë dhe Prezantojë informata ode dhe koncepte nga të dhënat përkatëse.

Aftësi të vlerësojë çështje teorike dhe praktike, të japi shpjegim për shkaqet dhe të zgjedh zgjidhje përkatëse.

Ndërmerr iniciativa t'i identifikojë nevojat për fitimin e dijenisë të mëtejme dhe mësim me shkallë të lartë të pavarësisë.

Aftësi të komunikojë dhe debatojë për informata, ide, probleme dhe zgjidhje, kur kriteret për vendosje dhe vëllimi i detyrave janë qartë të definuara si me publikun profesional, ashtu edhe me publikun joprofesional.

Tregon dijeni dhe kuptim në fushën e studimit ose punës që mbindërtohet mbi arsimin e mesëm të përgjithshëm të mbështetur me literaturë Profesionale.

Posedon dituri specialistike teorike dhe profesionale dhe kuptim të teorive të caktuara themelore nga fusha më e ngushtë shkencore dhe profesionale.

Posedon dituri të kufizuar nga rrjedhat bashkëkohore në fushën në të cilën punon ose studion që ofron përkrahje në

Zbaton shkathtësi që bazohen në kuptimin e parimeve teorike dhe zbatimin e tyre në zgjedhjen e problemeve dhe në kryerjen e detyrave të ndërlikuara dhe specifike në fushën e punës dhe mësim, me zgjedhje dhe përdorim të të dhënave relevante, metodave, procedurave, teknikave, instrumenteve, pajisjeve, veglave dhe materialeve;

Ka shkathtësi për mësim që të mund të ndërmarrë hulumtime të mëtejme me shkallë të caktuar të pavarësisë.

Posedon aftësi të komunikojë dhe

të pavarur, me qasje profesionale, në diskutime specifike shkencore dhe interdisiplinare.

Miraton vlerësim përkatës duke i marrë parasysh aspektet personale, shoqërore, shkencore dhe etike.

Ka shkallë më të lartë të përgjegjësisë personale dhe afaristë dhe vlerësim të punës personale dhe punës së grupit në bazë të kriterëve në sferën e punës.

Është i aftë për bartjen e diturisë të tjerëve, organizim, informim dhe kontroll të punës personale dhe punës së të tjerëve.

Ndërmerr përgjegjësi për rezultatet

V

	<p>fushën e punës ose profesionit, mundësi për zhvillim personal dhe bazë për studime të mëtejme që të përfundohet cikli i parë.</p>	<p>debatojë me grupe qëllimore nga profesioni më i ngushtë ose fusha e mësimit, me kolege, eprorë dhe klientë.</p>	<p>personale, por edhe përgjegjësi të ndarë për aktivitetet, rezultatet dhe punën e të tjerëve në grup.</p>
	<p>Njih koncepte, parime dhe procese nga lëndët dhe fushat e mësuara.</p>	<p>Posedon shkathtësi të ndryshme kognitive, praktike dhe kreative, të bazuara në dituri dhe parime teorike, të domosdoshme për mësim dhe punë dhe zgjidhje të problemeve në kushte të ndryshueshme në sferë të caktuar të punës ose mësimit;</p>	<p>Në mënyrë të pavarur e planifikon, organizon dhe udhëheq punën e vet dhe kryen mbikëqyrje në punën e përbashkët;</p>
<p>IV</p>	<p>Posedon dituri sistematike dhe profesionale në korniza të sferës së caktuar të punës ose mësimit, të cilat përfshijnë analizim dhe lidhshmëri të fakteve dhe parimeve teorike gjatë kryerjes të punës, e në të njëjtën kohë mundësojnë mësim të mëtejme.</p>	<p>Është i aftësuar të grumbullojë, analizoj, seleksionoj dhe të përdorë informata relevante nga burime të ndryshme, vegla, metodologji, teknika dhe materiale në sferën e mësimit.</p>	<p>Në mënyrë të pavarur kryen detyra të ndërlikuara dhe zgjidh probleme, duke e adaptuar sjelljen e tij, në pajtim me kahet e dhëna, në kushte të ndryshueshme;</p>
	<p>Është i aftësuar të realizojë veprime të ndërlikuara dhe të përdorë metoda, instrumente, vegla, stabilimente dhe materiale në punë.</p>	<p>Komunikon dhe bashkëpunon me grupin në kushte të ndryshueshme.</p>	<p>Është përgjegjës për punën personale, punën e grupit, në drejtim të vlerësimit të rezultateve të punës dhe avancimit të kualitetit, në pajtim me standardet dhe kriteret e përcaktuara paraprakisht.</p>
<p>III</p>	<p>Posedon dijeni profesionale të miratuara teorike dhe sistemore, fakte, parime, procese dhe koncepte të përgjithshme për sferë të veçantë të punës ose mësimit, e në të njëjtën kohë mundëson mësim të mëtejme.</p>	<p>Posedon shkathtësi praktike dhe kreative të cilat mundësojnë zgjidhjen e situatave të njohura (të parashikueshme) dhe më pak të njohura (të paparashikueshme). Kryen punë dhe detyra të cilat janë me ndërlikueshmëri të mesme, më pak të standardizuara dhe relativisht të qarta.</p>	<p>Planifikon, përgatit organizon dhe e vlerëson punën e vet, në bazë të autorizimeve të dhëna paraprakisht, në korniza të fushëveprimit të punës së vet;</p>
	<p>Shfrytëzon aparate, vegla, pajisje dhe materiale të ndryshme në procesin e prodhimit dhe në</p>	<p>Kryen punë, të cilat nuk janë përherë të definuara paraprakisht, me</p>	

	shërbime.	shkallë të caktuar të pavarësisë dhe përgjegjësisë.
	Komunikon dhe bashkëpunon me grupin.	
II	Posedon dituri themelore teorike dhe profesionale të nevojshme për njohjen e sferës së punës dhe mund t'i zbatojë gjatë kryerjes së detyrave të thjeshta të punës, e në të njëjtën kohë mundësojnë mësim të mëtejshëm.	Punën në mënyrë të pavarur në kushte të njohura me mbikëqyrje të përkohshme dhe me përgjegjësi të kufizuar për kryerjen e detyrave të punës;
	Shfrytëzon metoda të thjeshta, vegla, instrumente, aparate dhe materiale në bazë të udhëzimeve të hollësishme.	Realizon komunikim të thjeshtë dhe bashkëpunon me një pjesë të të punësuarve në situata të njohura.
	Komunikon dhe bashkëpunon me persona të veçantë.	
I	Posedon dijeni bazë për funksionin të lëndëve dhe dukurive të caktuara me mundësi t'i zbatojë në praktik dhe disiplinat të tjera, ndërsa në të njëjtën kohë mundëson edhe mësim të mëtejshëm.	Kryen detyra të thjeshta me mbikëqyrje të drejtpërdrejtë;
	Shfrytëzon metoda të thjeshta, vegla dhe instrumente me udhëzime dhe nën mbikëqyrje;	Ndërmerr përgjegjësi për kryerjen e detyrave të thjeshta.
	Posedon rregulla të përgjithshme të komunikimit.	

Vëllimi i kualifikimeve

Neni 8

(1) Për çdo kualifikim caktohet vëllimi, përkatësisht koha mesatare e përgjithshme e shpenzuar e nevojshme për marrjen e kualifikimi të caktuar. Vëllimi i kualifikimeve, përkatësisht vlera e tyre kreditore përcaktohet me numrin e kredive.

(2) Me kredi matet ngarkimi i kandidatit që mëson duke pasur parasysh kohën që nevojitet për marrjen e një kualifikimi, përkatësisht për realizimin e rezultateve nga mësimi.

(3) Për çdo program arsimor, modul, lëndë mësimore ose njësi tjetër të mësimimit i ndahet numër i caktuar i kredive.

(4) Koha e përgjithshme mesatare e shpenzuar për marrjen e kualifikimit të caktuar tregohet në SETK (Sistemi evropian i transferit të kredive dhe akumulimit) për kreditë në arsimin e lartë, SETKATP (Sistemi evropian i transferit të kredive për arsim dhe trajnim profesional) për kreditë në arsimin dhe trajnimin profesional dhe SMKAP (Sistemi maqedonas i kredive për arsim të

përgjithshëm) për kreditë në arsimin fillor, arsimin e gjimnazit dhe lëndët e përgjithshme arsimore në arsimin dhe trajnimin profesional.

(5) Për kualifikime që merren në bazë të hulumtimeve origjinale shkencore ose artistike koha e përgjithshme mesatare e shpenzuar paraqitet me numrin e viteve të hulumtimit në vendin e punës.

(6) Një kredi SETK përfshin 30 orë punë në kohëzgjatje prej nga 60 minuta të nevojshme për fitimin e rezultateve të caktuara nga mësimi.

(7) Një kredi SETKATP përfshin 25 orë punë në kohëzgjatje prej nga 45 minuta të nevojshme për fitimin e rezultateve të caktuara nga mësimi.

(8) Një kredi SMKAP përfshin 25 orë pune në kohëzgjatje prej nga 45 minuta të nevojshme për fitimin e rezultateve të caktuara nga mësimi.

(9) Numri më i madh të kredive nga paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij neni, nuk mund të jetë më i vogël se një kredi.

(10) Vëllimi i kualifikimeve për nivel të arsimit caktohet me së paku 60 kredi, që i përgjigjet një viti shkollor, përkatësisht viti studimor.

Nivele dhe nënnivele të kualifikimeve

Neni 9

Në Kornizën maqedonase të kualifikimeve ka tetë nivele dhe gjashtë nënnivele:

- niveli I ka të bëjë me arsim të përfunduar fillor dhe nxënësit pajisen me dëftesë, e në arsimin dhe trajnimin joformal ka të bëjë me dituri dhe shkathtësi për arsim funksional dhe shkathtësi numerike dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikatë,
- niveli II ka të bëjë me aftësimin profesional në kohëzgjatje prej dy vitesh dhe pjesëmarrësit marrin vërtetim për aftësim profesional, e në arsimin dhe trajnimin joformal ka të bëjë me trajnime për marrjen e kualifikimeve ose pjesë të kualifikimeve (niveli i ndërlikueshmërisë 1 dhe 2 në pajtim me standardet e profesioneve) dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikatë,
- niveli III ka të bëjë me arsimin profesional për profesione në kohëzgjatje prej tri vitesh dhe pjesëmarrësit pajisen me diplomë, e në arsimin dhe trajnimin joformal ka të bëjë me trajnime për marrjen e kualifikimeve ose pjesë të kualifikimeve (niveli i ndërlikueshmërisë 3 në pajtim me standardet e profesioneve) dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikatë. Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore për nivelin III arsimohen katër vite dhe pajisen me diplomë,
- niveli IV ka të bëjë me arsimin e gjimnazit, arsimin teknik, arsimin artistik në kohëzgjatje prej katër vitesh dhe pjesëmarrësit pajisen me diplomë, e në arsimin dhe trajnimin joformal ka të bëjë me trajnime për marrje të kualifikimeve ose pjesë të kualifikimeve (niveli i ndërlikueshmërisë 4 në pajtim me standardet të profesioneve) dhe pjesëmarrësit pajisen me certifikatë. Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore për nivelin IV arsimohen pesë vite dhe pajisen me diplomë,
- niveli V nënniveli VB ka të bëjë me arsimin pas arsimit të mesëm (arsim specialistik dhe provimi për mjeshtrë) dhe pjesëmarrësit marrin diplomë për arsim specialistik dhe diplomë për

provim të mjeshtrit,

- niveli V nëniveli VA ka të bëjë me programet e shkurtra profesionale studimore në arsimin e lartë dhe pjesëmarrësit marrin vërtetim,

- në nivelin VI nënivelet VIB dhe VIA kanë të bëjnë për studimet trevjeçare dhe katërvjeçare diplomike dhe pjesëmarrësit marrin diplomë,

- në nivelin VII nënivelet VIIA dhe VIIB kanë të bëjnë me studimet e magjistraturës dhe specialistike dhe pjesëmarrësit marrin diplomë dhe

- niveli VIII ka të bëjë me studimet e doktoraturës dhe pjesëmarrësit marrin diplomë.

Numri i kredive të cilat merren nga nivelet dhe nënivelet e kualifikimeve në Kornizën maqedonase të kualifikimeve dhe krahasimi me nivelet e Kornizës evropiane të kualifikimeve

Neni 10

Nivel i KM K	Nën nivel i	Arsimimi i përgjithshëm	Arsimimi dhe trajnimi formal profesional	Arsimi dhe trajnimi joformal	Arsimi I lartë	Nivel i KEK
VIII					Cikli III i studimeve të doktoraturës	8
	VII A				Cikli II i studimeve të magjistraturës dhe akademike (prej 60 deri 120 kredit)	7
VII					Cikli II i studimeve specialistike (60 kredi)	
	VII B				Cikli i studimeve universitare (240 kredi) Studime profesionale (240 kredi)	6
VI					Cikli i studimeve universitare (160 kredi) Studime profesionale (180 kredi)	
	VI A				Studime profesionale (preje 60 deri 120 kredi)	5
V					Programe studimor	
	V A					

				e profesionale të shkurta ne kuadër të ciklit të parë	
V B		Aftësimi pas arsimit të mesëm (arsim specialistik dhe provim i mjeshtrit)	Arsimi pas arsimit të mesëm (arsim specialistik dhe provimi mjeshtrit)	Arsimi pas arsimit të mesëm (prej 60 deri 120 kredi)	
IV	Arsimi i gjimnazit (240 kredit)	Arsimi teknik katërvjeçar (240 kredi)	Arsimi joformal për marrjen e kualifikimit ose një pjese të kualifikimit (nivelit i ndërlíkueshmërisë A, në pajtim me standardet e profesioneve)		4
III		Arsim profesional për profesione ne kohëzgjatje prej tre vjet (160 kredit)	Arsimi joformal për marrjen e kualifikimit ose një pjese të kualifikimit (nivelit i ndërlíkueshmërisë 3, në pajtim me standardet e profesioneve)		3
II		Aftësimi profesional në kohëzgjatje deri në dy vjet (prej 60 deri 120 kredi)	Arsim joformal për marrjen e kualifikimit ose një pjese të kualifikimit (niveli i ndërlíkueshmërisë 1 dhe 2 në pajtim me standardet e profesioneve)		2
I	Arsimi fillor		Njohuria funksionale dhe aftësitë numerike		1

Tipat e kualifikimeve

Neni 11

Tipat e kualifikimeve janë:

- kualifikime në nivel të arsimit (niveli arsimor) dhe
- kualifikime profesionale.

Marrja e kualifikimeve

Neni 12

(1) Kualifikimet në nivel të arsimit merren me përfundimin e arsimit për programe arsimore të miratuara publikisht dhe arritje të rezultateve dalëse nga të njëjtat, pas kontrollit të kryer të përcaktuar me ligj. Kualifikimet, sipas përfshirjes së njohurisë së përgjithshme dhe profesionale dhe të kompetencave, mundësojnë zhvillim personal dhe profesional, përkatësisht mundësi për vazhdimin e arsimit ose për përfshirje në tregun e punës (punësim).

(2) Dëshmi për kualifikimin e marrë në nivel të arsimit paraqet dëftesa, certifikata dhe diploma.

(3) Kualifikimet profesionale merren për një pjesë të programeve arsimore të miratuara publikisht, moduleve ose kurseve, ose me përfundimin e programeve të veçanta për arsim, pas kontrollit të kryer në pajtim me ligjin. Këto kualifikime paraqesin aftësim të pranuar formal për kryerjen e punëve në kuadër të një ose më shumë profesioneve në nivel të caktuar të kërkesave.

(4) Kualifikimet profesionale japin dëshmi se janë arritur grupe më të vogla të rezultateve të mësimin ose kombinime të rezultateve të mësimin, të cilat nuk i plotësojnë kërkesat e arritjeve për nivel arsimor.

(5) Kualifikimet profesionale përmbajnë kompetenca profesionale nga një ose më shumë standarde të profesioneve.

(6) Kualifikimet profesionale të marra në mënyrë joformale vlerësohen dhe vërtetohen nga komisioni profesional i formuar nga Komisionet e sektorëve nga neni 18 i këtij ligji. Vlerësimi profesional dhe vërtetimi do të thotë evoluim i dëshmive dhe evoluim i shkathësive praktike dhe njohurive.

(7) Dëshmi për kualifikimin e marrë profesional paraqet certifikata.

Zhvillimi i kualifikimeve

Neni 13

(1) Kompetente për zhvillimin e kualifikimeve nga niveli I deri V-B të kualifikimeve janë:

- Qendra për arsim dhe trajnim profesional,
- Qendra për arsim të të rriturve dhe
- Byroja për zhvillim të arsimit.

(2) Kompetente për zhvillimin e kualifikimeve nga niveli V-A deri VIII janë institucionet e arsimit të lartë.

Kualifikime të sektorit

Neni 14

(1) Kualifikimet grupohen sipas sektorit të cilit i takojnë.

(2) Sektorët e kualifikimeve përmbajnë nënsektorë, sfera dhe nënsfera.

(3) Nënsektorët, sferat dhe nënsferat i definojnë komisionet e sektorëve sipas përmbajtjes së punës, në pajtim me nevojat e tregut të punës, ekonomisë, shoqërisë dhe arsimit, si dhe gjatë grupimit të kualifikimeve të cilat kanë përmbajtje të njëjtë ose të ngjashme të njohurive dhe shkathtësive, përkatësisht rezultate të mësimin.

(4) Sektorë të kualifikimeve në arsimin profesional janë:

- 1) gjeologjia, xehetaria dhe metalurgjia;
- 2) ndërtimtaria dhe gjeodezia;
- 3) veprimtaria grafike;
- 4) ekonomia, drejtësia dhe tregtia;
- 5) elektroteknika;
- 6) shëndetësia dhe mbrojtja sociale;
- 7) bujqësia, peshkataria dhe veterinarja;
- 8) shërbimet personale;
- 9) makineria;
- 10) komunikacioni, transporti dhe magazinimi;
- 11) tekstil, lëkura dhe prodhime të ngjashme;
- 12) hoteleria dhe turizmi;
- 13) kimia dhe teknologjia;
- 14) pylltaria dhe përpunimi i drurit;
- 15) sporti dhe rekreacioni dhe
- 16) arti.

(5) Për kualifikimet e arsimit të lartë zbatohet klasifikimi ndërkombëtar i Fraskatit i lëmenjve, fushave dhe sferave shkencore.

(6) Çdo sektor i kualifikimeve ka kornizë të tij në të cilën zhvendosen kualifikimet sipas llojit dhe niveleve. Korniza e sektorit të kualifikimeve mundëson të konstatohet raporti ndërmjet llojeve dhe niveleve të kualifikimeve në sektorin dhe nga e njëjta mund të shihet mundësia për kalueshmërinë dhe avancimin në korniza të sektorit dhe marrja e kualifikimit të njëjtë në rrugë të ndryshme (pas programit të përfunduar arsimor, pas kontrollit të njohurisë së marrë paraprakisht, aftësive dhe kompetencave e ngjashëm).

(7) Kornizat kualifikuese të sektorëve përpilohen në bazë të analizës së gjendjeve në sektorin, përkatësisht sferën e punës (gjendja në tregun e punës, mundësia për marrjen e kualifikimeve, tendencat në zhvillimin e veprimtarisë, zbatimi ndërkombëtar e ngjashëm).

(8) Kornizat kualifikuese të sektorëve janë në mënyrë zhvillimore të konceptuara dhe të hapura për plotësim me kualifikime të reja në pajtim me nevojat dhe ndryshimet në tregun e punës.

III. ORGANE KOMPETENTE, INSTITUCIONE, TRUPA DHE KOMISIONE

Neni 15

Organe kompetente, institucione, trupa dhe komisione për zhvillim, kontroll, miratim, pranim dhe klasifikim të kualifikimeve në Kornizën maqedonase të kualifikimeve kombëtare janë:

- Këshilli Nacional për Kornizën Maqedonase të Kualifikimeve,
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale,
- Byroja e Zhvillimit të Arsimit,
- Qendra e Arsimit dhe Trajnimit Profesional,
- Qendra e Arsimit të të Rriturve dhe
- komisione të sektorit për kualifikime.

Këshilli Nacional për Kornizën Maqedonase të Kualifikimeve

Neni 16

(1) Me qëllim për avancim të sistemit të kualifikimeve, miratim dhe klasifikim të kualifikimeve në Kornizën maqedonase të kualifikimeve, formohet Këshilli Nacional për Kornizën Maqedonase të Kualifikimeve (në tekstin e mëtejme: Këshilli Nacional).

(2) Këshilli Nacional ka vulë i cili përmban mbishkrim: Republika e Maqedonisë - Këshilli Nacional për Kornizën Maqedonase të Kualifikimeve - Shkup. Në mesin e vulës është stema e Republikës së Maqedonisë.

(3) Këshilli Nacional përbëhet nga kryetari dhe dhjetë anëtarë.

(4) Kryetar i Këshilli Nacional është njëri nga anëtarët e Këshillit Nacional dhe të njëjtin e zgjedhin anëtarët në mbledhjen konstitutive të cilën e konvokon ministri kompetent për punët e arsimit. Kryetari i Këshillit Nacional e prezanton dhe përfaqëson Këshillin Nacional.

(5) Anëtarë Këshilli Nacional janë nga një përfaqësues i emëruar nga:

- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale,
- Qendra e Arsimit dhe Trajnimit Profesional,
- Qendra e Arsimit të të Rriturve,
- Byroja e Zhvillimit të Arsimit,
- Agjencia Kombëtare për Programe Arsimore Evropiane dhe Mobilitet,
- Institucioni i arsimit të lartë, të cilin e propozon Konferenca Inter-universitare,

- Dhoma Ekonomike e Republikës së Maqedonisë, Lidhja e Dhomave të Republikës së Maqedonisë, Dhoma e Zejtarëve të Republikës së Maqedonisë dhe Dhoma Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore,
- Sindikata e Pavarur e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Maqedonisë dhe
- dy përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

(6) Kryetar dhe anëtar të Këshilli Nacional mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- ka përfunduar arsim të lartë dhe
- ka së paku pesë vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave dy vite në sferën e mësimit gjatë gjithë jetës dhe kualifikimeve.

(7) Kryetari dhe anëtarët e Bordit nacional emërohen për katër vite, me të drejtë edhe për një emërim.

(8) Anëtarët e Këshillit Nacional janë të pavarur dhe të mëvetësishëm në punën e tyre dhe nuk mund të revokohen para përfundimit të kohës për të cilën janë emëruar, përveç kur anëtarit të Këshillit Nacional i ka pushuar statusi i punësuar në institucionin përfaqësues i të cilit është si anëtar në bord në çfarëdo qoftë baze, kur është i emëruar ose i zgjedhur në funksion për shkak të të cilit nuk do të mund të emërohet si anëtar, kur Këshilli Nacional konstaton se anëtari më gjatë se gjashtë muaj nuk është në gjendje t'i kryejë detyrimet dhe kur ekziston konflikt i interesit i përcaktuar me ligj.

(9) Këshilli Nacional i kryen punët në vijim:

- kryen vlerësim të politikave për arsim, punësim, orientim profesional gjatë gjithë jetës dhe zhvillim rajonal nga aspekti i zhvillimit të potencialit njerëzor dhe kontributit të tij në rritjen e konkurrencës në Republikën e Maqedonisë,
- jep rekomandime për përmirësim në lidhshmërinë e arsimit me nevojat e tregut të punës,
- miraton vendime për sistemim të kualifikimeve në Kornizën maqedonase të kualifikimeve,
- propozon zhvillim dhe avancim të kualifikimeve deri te institucionet kompetente,
- miraton vendime për harmonizim të kualifikimeve ekzistuese me Kornizën maqedonase të kualifikimeve,
- e ndjek zhvillimin e Kornizës maqedonase të kualifikimeve në tërësi,
- zhvillon dhe miraton dokumente metodologjike për klasifikim të kualifikimeve,
- formon komisione të sektorit për kualifikime,
- përcakton kritere përkatëse për punën e komisioneve të sektorit për kualifikime dhe jep instruksione për punën e tyre,
- vendos për definimin e nënsektorëve, sferave dhe nënsferave në kornizat e sektorëve të kualifikimeve,
- shqyrton dhe miraton raporte të dorëzuara nga komisionet e sektorit për kualifikime dhe
- jep rekomandime për punën e komisioneve të sektorit për kualifikime, në bazë të raporteve të dorëzuara.

(10) Punët profesionale dhe administrative për nevojat e Bordit nacional i kryen Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

(11) Për punën e vet Këshilli Nacional dorëzon raport për miratim te Qeveria e Republikës së Maqedonisë, më së voni deri më 31 janar, për vitin paraparak.

(12) Kryetarit dhe anëtarët të Këshilli Nacional u takon kompensim për punën në Bordin nacional, lartësinë e të cilit e përcakton Qeveria, në bazë të pranisë në mbledhjet e bordit.

(13) Mjetet për punë të Këshilli Nacional sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në program të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe nga të hyrat personale.

(14) Ministri kompetent për punët e arsimit me akt i përcakton llojin dhe lartësinë e kompensimeve për shpenzimet në procedurën e miratimit dhe klasifikimit të kualifikimeve në Kornizën maqedonase të kualifikimeve, në bazë të shpenzimeve të bëra reale.

(15) Organizimi, puna, mënyra e vendosjes, metodologjia për miratimin dhe klasifikimin e kualifikimeve në Kornizën maqedonase të kualifikimeve, standardet për miratim dhe klasifikim të kualifikimeve në Kornizën maqedonase të kualifikimeve, si dhe çështje tjera në lidhje me punën e Këshillit Nacional, më afërsisht rregullohen me rregullore.

(16) Rregulloren nga paragrafi (15) të këtij neni e miraton Këshilli Nacional, pas pëlqimit të marrë paraparakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Trupa dhe organe kompetente për koordinim për zbatimin dhe zhvillimin e Kornizës maqedonase të kualifikimeve

Neni 17

(1) Koordinimin e zbatimit dhe zhvillimit të Kornizës maqedonase të kualifikimeve e kryejnë Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(2) Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

- jep udhëzime për zhvillim të standardeve të kualifikimeve,
- e lidh Kornizën maqedonase të kualifikimeve me Kornizën evropiane të kualifikimeve dhe me Kornizën e kualifikimeve të Hapësirës evropiane të arsimit të lartë,
- e ndjek zbatimin dhe zhvillimin e kornizave kombëtare të kualifikimeve në shtete tjera dhe
- e informon publikun për çështje profesionale të lidhura me Kornizën maqedonase të kualifikimeve.

(3) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale:

- vendos dhe zhvillon sistem për marrjen e informatave për nevojat e tashmë dhe të ardhme të tregut të punës dhe kompetencave të nevojshme,
- grumbullon të dhëna për ndryshime të kompetencave për profesionet e nevojshme,
- propozon zhvillim të standardeve të kualifikimeve dhe standarde të profesioneve sipas nevojave të tregut të punës,
- merr pjese në përpilimin e dokumenteve strategjike dhe analizave për zhvillimin e Kornizës maqedonase të klasifikimeve me qëllim të rritjes së punësimit dhe zhvillimit të konkurrencës së

Republikës së Maqedonisë,

- zhvillon metodologji për përpilimin e standardeve të profesioneve dhe
- e ndjek punësimin e personave me kualifikime të marra.

Komisione të sektorit për kualifikime

Neni 18

(1) Këshilli Nacional, për çdo sektor për kualifikim nga neni 14 paragrafi (4) të këtij ligji, formon komision të sektorit për kualifikime.

(2) Komisioni i sektorit për kualifikime ka kryetar dhe tetë anëtarë, edhe atë nga një nga: ministria kompetente, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shoqata e punëdhënësve nga sektori përkatës, sindikata reprezentative e të punësuarve nga sektori përkatës, universitetet, Qendra e Arsimit dhe Trajnimit Profesional, Qendra e Arsimit të të Rriturve, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, trupi përkatës kompetent për profesione të rregulluara (Dhoma e Avokatëve, Dhoma e Mjekëve, Dhoma e Inxhinierëve etj.).

(3) Përfaqësuesin nga universitetet e propozon Konferenca Inter-universitare, sipas nënsektorëve, sferave dhe nënsferave të punës së komisionit të sektorit.

(4) Kryetari dhe anëtarët e komisionit të sektorit për kualifikime kanë mandat prej katër viteve, me të drejtë edhe për një mandat.

(5) Komisioni i sektorit për kualifikime miraton rregullore për punën e vet, për të cilën pëlqim jep Këshilli Nacional.

(6) Punët profesionale dhe administrative për nevojat e komisionit të sektorit për kualifikime i kryen Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

(7) Kryetarit dhe anëtarëve të komisionit të sektorit për kualifikime u takon kompensim për punën në komisionin e sektorit, lartësinë e të cilit e përcakton ministri kompetent për punët e arsimit, në bazë të pranisë në mbledhjet e komisionit të sektorit.

Kompetenca të komisioneve të sektorit për kualifikime

Neni 19

Komisionet e sektorit për kualifikime:

- e analizojnë gjendjen dhe tendencat e tregut të punës,
- propozojnë kualifikime për sektor/nënsketor të kualifikimeve prej nivelit I deri në nivelin V, përkatësisht për lëmi, fushë dhe sferë shkencore për kualifikimet nga niveli VII deri në nivelin VIII,
- i analizojnë kualifikimet ekzistuese,
- kryejnë evoluim të kualifikimeve ekzistuese,
- i identifikojnë nevojat për të gjitha llojet e kualifikimeve në pajtim me nevojat e tregut të punës dhe shoqërisë në tërësi,

- shqyrtojnë propozime për vendosjen e kualifikimeve të reja,
- propozojnë prioritete në zhvillimin e kualifikimeve të reja ose plotësimin e atyre ekzistuese,
- e përgatisin profilin themelor të kualifikimit,
- japin mendim për harmonizimin e standardeve të profesioneve/standardeve të kualifikimeve me programet e provimeve,
- formojnë komision për vlerësim dhe vërtetimin e rezultateve nga mësimi (njohuri, shkathtësi dhe kompetenca) në arsimin dhe trajnimin joformal,
- i promovojnë sektorët e kualifikimeve dhe mundësitë për punësim në to dhe
- dorëzojnë raporte vjetore për punën e vet te Këshilli Nacional.

IV. REGJISTRI I KORNIZËS MAQEDONASE TË KUALIFIKIMEVE DHE SIGURIMI I KUALITETIT NË ZBATIMIN E KORNIZËS MAQEDONASE TË KUALIFIKIMEVE

Regjistri i Kornizës maqedonase të kualifikimeve

Neni 20

(1) Kualifikimi i miratuar nga Bordi nacional regjistrohet në Regjistrin e Kornizës maqedonase të kualifikimeve (në tekstin e mëtejme: Regjistri).

(2) Çdo kualifikimi të miratuar i ndahet kod sipas tipit, nivelit, vëllimit, sektorit të kualifikimit dhe institucionit në të cilin merret kualifikimi.

(3) Regjistri përbëhet nga katër nënregjistra:

- Nënregjistri për kualifikime të arsimit të lartë,
- Nënregjistri për kualifikime të arsimit të përgjithshëm,
- Nënregjistri për kualifikime profesionale dhe
- Nënregjistri për kualifikime të marra nga arsimit joformal.

(4) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së Regjistrin i përcakton ministri i Arsimit dhe Shkencës.

(5) Regjistri mbahet edhe në formë elektronike.

(6) Të dhënat nga Regjistri dorëzohen te Enti Shtetëror për Statistikë, më së voni deri më 31 janar për vitin paraprak.

Regjistrimi në Regjistrin dhe mbajtja e Regjistrin

Neni 21

(1) Kërkesë për regjistrim të kualifikimit në Regjister mund të parashtrijë person juridik ose fizik.

(2) Për kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, vendos Bordi nacional, pas mendimit paraprak nga komisioni përkatës i sektorit për kualifikime.

(3) Nënregjistrin për kualifikime të arsimit të lartë dhe Nënregjistrin për kualifikime të arsimit të përgjithshëm i mban Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

(4) Nënregjistrin për kualifikime profesionale e mban Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional.

(5) Nënregjistrin për kualifikime të marra nga arsimi joformal e mban Qendra për Arsim të të Rriturve.

Sigurimi i kualitetit në zbatimin e Kornizës maqedonase të kualifikimeve

Neni 22

Sigurimi i kualitetit në zbatimin e Kornizës maqedonase të kualifikimeve ka të bëjë me kualitetin e kualifikimeve në Kornizën maqedonase të kualifikimeve, me procedurat të cilat çojnë në marrjen e kualifikimit dhe dëftesave, diplomave, vërtetimeve dhe certifikatave të cilat u ndahen pjesëmarrësve të cilët e kanë marrë kualifikimin.

Procedura për sigurim dhe avancim të kualitetit të kualifikimeve

Neni 23

(1) Procedura për sigurim dhe avancim të kualitetit të kualifikimeve në Kornizën maqedonase të kualifikimeve janë:

- vlerësimi i kualifikimeve,
- verifikimi i institucioneve të cilat realizojnë programe mësimore/studimore, përkatësisht programe të veçanta për arsim të të rriturve.
- verifikimi, përkatësisht akreditimi i programeve mësimore/studimore, përkatësisht programeve të veçanta për arsim të të rriturve,
- puna edukative arsimore, përkatësisht puna e arsimit të lartë,
- vlerësimi i nxënësve/studentëve/pjesëmarrësve në programet nga paragrafi (1) alineja 3 të këtij neni,
- dhënia e dokumenteve publike (dëftesa, diploma, vërtetime dhe certifikata),
- evoluimi i programeve dhe institucioneve, vetëvaluimi, vlerësimi i jashtëm ose revizioni i jashtëm dhe shpallja e rezultateve,
- procedura për nostrifikim dhe ekuivalencë të dëftesave dhe diplomave për arsimin fillor dhe të mesëm të marrë jashtë vendit dhe pranimi dhe ekuivalenca e diplomave për arsimin e lartë të marrë jashtë vendit dhe
- pjesëmarrja ndërkombëtare, bashkëpunimi dhe kyçja në rrjet në rrjetet evropiane/botërore për pranim të kualifikimeve dhe sigurimi i kualitetit.

(2) Procedurat nga paragrafi (1) i këtij neni janë në pajtim me ligjet nga veprimtaritë përkatëse të arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë, arsimit profesional dhe trajnimit dhe arsimit të të rriturve.

(3) Vlerësimin dhe vërtetimin e rezultateve nga mësimi (njohuri, shkathtësi dhe kompetenca) në arsimin dhe trajnim joformal e kryen komisioni i përbërë nga një anëtar nga: Ofruesi i arsimit dhe trajnimit, punëdhënësit dhe institucionet nga sfera e arsimit.

(4) Komisionin nga paragrafi (3) të këtij neni e formon kryetari i komisionit të sektorit.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Ekuivalenca e kualifikimeve ekzistuese me Kornizën maqedonase të kualifikimeve

Neni 24

Kualifikimet e marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji janë përkatëse me nivelet dhe nënnivelet në Kornizën maqedonase të kualifikimeve:

- arsimit i përfunduar fillor është ekuivalent me nivelin I,
- aftësimi i përfunduar profesional në kohëzgjatje deri në dy vite është ekuivalent me nivelin II,
- arsimit i përfunduar profesional për profesione në kohëzgjatje prej tre viteve dhe për nxënës me nevoja të posaçme arsimore me kohëzgjatje prej katër viteve është ekuivalent me nivelin III,
- arsimit i përfunduar i gjimnazit, arsimit teknik, arsimit i artit në kohëzgjatje prej katër viteve, dhe për nxënës me nevoja të posaçme arsimore në kohëzgjatje prej pesë viteve është ekuivalent me nivelin IV,
- arsimit i përfunduar pas arsimit të mesëm (arsimi specialistik dhe provimi i mjeshtërit) është ekuivalent me nivelin V nëniveli VB,
- programe studimore profesionale të shkurtra të përfunduara në arsimin e lartë është ekuivalente me nivelin V nëniveli VA,
- studimet diplomike të përfunduara trevjeçare dhe katërvjeçare janë ekuivalente me nivelin VI nënnivelet VIB dhe VIA,
- studimet e përfunduara të magistraturës dhe specialistike janë ekuivalente me nivelin VII nënnivelet VIIA dhe VIIB dhe
- studimet e përfunduara të doktoraturës janë ekuivalente me nivelin VIII.

Neni 25

(1) Mbledhjen konstitutive të Bordit nacional ministri kompetent për punët e arsimit e konvokon në afat prej gjashtë muajve nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

(2) Këshilli Nacional në afat prej gjashtë muajve nga dita e formimit të tij i formon komisionet e sektorit për kualifikime.

Neni 26

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 30 shtatori 2015.